



Prishtinë, 23 dhjetor 2014
Kodi i ZRRE-së: V_674_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 4.2 dhe 22.2 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Dispozitat e Nenit 7.4 të Licencës së Operatorit të Tregut,
- Kërkesën e KOSTT SH.A për Derrogimin e dispozitave të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut, Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Licencës së Operatorit të Tregut të datës 5 dhjetor 2014,

në seancën e mbajtur me datë 23 dhjetor 2014, nxori këtë:

V E N D I M

I - I lejohet KOSTT SH.A. derrogimi në zbatimin e dispozitave të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut, Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Licenca e Operatorit të Tregut si në Shtojcë të këtij vendimi.

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 5 dhjetor 2014 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A për derrogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut, Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Licencës së Operatorit të Tregut. Pas vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale të Sistemit të Transmisionit, ZRRE ka parë të arsyeshme që të lejojë shtyrje të afatit në zbatimin dispozitave të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Licencës së Operatorit të Tregut në afatet e vendosura si në Shtojcë.

Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Licencës së Operatorit të Tregut do të mbesin në fuqi.

II - Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.


III - Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE - së.





Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Kopje: Raporti i derrogimeve

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar